



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 95, datë 10.12.2018

PËR

“PËRFUNDIMIN E PROCEDIMIT ADMINISTRATIV PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES MIDIS NISATEL SH.P.K – ALBTELECOM SH.A”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Illir	Zela	Kryetar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtare
Znj.	Klarina	Allushi	Anëtare
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtare

dhe sekretare Sindi Dushku, në mbledhjen e datës 10.12.2018, shqyrtoi çështjen me objekt:

- 1. Përfundimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve “Nisatel shpk” dhe “Albtelecom sh.a”.*

BAZA LIGJORE:

1. Shkronjat a),b),n), të nenit 8, neni 120, të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Nenet 5, 14, 16, pika 1 e nenit 23, pika 1 e nenit 41, neni 44, pika 2 e nenit 79, nenet 81, 82, 87, të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);

3. Shkronja e), pika 10 e nenit 5 dhe neni 15, i Rregullores së AKEP nr.19, datë 14.06.2010 për “*Aksesin dhe Interkoneksionin*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1300, datë 14.06.2010, ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1373, Datë 10.09.2010 e ndryshuar (***Rregullore nr.19***);
4. Rregullore e AKEP nr.18, datë 11.06.2010 për “*Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1296, Datë 11.06.2010 (***Rregullore nr.18***);
5. Pika p, e nenit 19 të Rregullores së Brendshme per Funkcionimin e Keshillit Drejtues, miratuar me Vendim nr.7, datë 16.02.2017 të Keshillit Drejtues të AKEP.

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.85, datë 30.10.2018, “*Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. – Albtelecom sh.a.*”;
2. Komunikimi elektronik ndërmjet KZM, Albtelecom sh.a dhe Nisatel shpk;
3. Njoftimi elektronik i Nisatel sh.p.k mbi rezultatin e negociatës së zhvilluar ndërmjet palëve në mosmarrëveshje si dhe dakortësinë e arritur për zgjidhje me mirëkuptim;
4. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (*Relacioni*);
5. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar.

si dhe pasi e diskutoi në tërësi çështjen,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin nr. 85, datë 30.10.2018, “*Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. – Albtelecom sh.a.*”, ka vendosur:
 - *Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.*”;
 - *Të njoftohen palët e interesuara Nisatel sh.a. dhe Albtelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;*
 - *Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 7 ditëve nga marrja e vendimit*”;
2. KZM e ngritur me VKD nr.85, datë 30.10.2018, “*Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.*”, duke e konsideruar me rëndësi mosmarrëveshjen e krijuar ndërmjet dy subjekteve “Nisatel shpk” dhe “Albtelecom sh.a”, njëkohësisht duke qënë në dijeni të

pretendimeve, provave dhe argumenteve të referuara në materialet, provat dhe pretendimet e shkëmbyera gjatë procesit të negociimit ndërmjet palëve, më datë 08.11.2018 sipas planifikimit të bërë dhe të dakortësuar në rrugë elektronike me palët, realizoi takimin ndërmjetësues si pjesë e procesit të zgjidhjes së momarrëveshjes ndërmjet palëve Nisatel shpk dhe Altelecom sh.a, si një mundësi shtesë për të shqyrtuar pretendimet paraprakisht në një tryezë të përbashkët.

3. Nga takimi i realizuar ndërmjet palëve u kërkua dhe u dakortësua që:

- Palëve t'u jepej mundësia të shfrytëzonin një takim tjetër dypalësh pa prezencën e KZM, takim i cili të shërbejë në gjetjen e alternativave për zgjidhjen e mosmarrëveshjes pa kaluar në veprime të tjera procedurale, siç parashikon Rregullorja e Akses Interkoneksionit si dhe Marrëveshjet e Interkoneksionit përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Altelecom sha. dhe Nisatel shpk. Kjo kërkese u dakortësua për ti shërbyer ruajtjes së frymës së bashkëpunimit për zgjidhje pa cënuar interesat reciproke të tyre;
- Palët morën detyrimin që do të informojnë KZM për produktin e negociatës pas zhvillimit të saj;
- Afati për zhvillimin e takimit ndërmjet palëve për qëllimin e cituar më sipër të mos jetë më shumë se 10 ditë nga data e takimit të ndërmjetësuar nga KZM, në kuadrin e vijimit të procesit administrativ të filluar nga AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe mbylljen e këtij procesi.

4. Nisatel shpk, si palë iniciuese për përfshirjen e AKEP në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Nisatel shpk dhe Altelecom sh.a ka njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 03.12.2018, KZM e ngritur me VKD nr.85 datë 30.10.2018, për "Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a për rezultatin e negociatës së zhvilluar me Altelecom sh.a si dhe dakortësinë e arritur ndërmjet tyre.

Nisatel shpk, ka shprehur vlerësimin për rolin pozitiv të KZM të AKEP në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje dhe për takimin e realizuar në seancën e ndërmjetësimit për gjetjen e zgjidhjes për mosmarrëveshjen e krijuar, pasi ky takim shërbeu si shtysë në gjetjen e zgjidhjes me mirëkuptim të mosmarrëveshjes ndërmjet palëve.

5. Këshilli Drejtues i AKEP, në përfundim të këtij procedimi administrativ të filluar me Vendimin Nr.85, datë 30.10.2018 për "Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a", pasi ka shqyrtuar procesin e ndjekur nga KZM dhe duke konsideruar rezultatin e arritur ndërmjet palëve në mosmarrëveshje, në përputhje me qëllimin e delegimit të veprimeve të hetimit administrativ për procedurën administrative në fjalë në respektim të parimit të ushtrimit të ligjshëm të kompetencave, gjykon se gjatë gjithë procesit, KZM ka patur si qëllim të ofrojë një zgjidhje sa më të shpejtë, të sigurojë të drejtat e palëve dhe të përmbushë objektivat rregullatorë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në pikën 1 të nenit 114-të Ligjit nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe neneve 33 e vijues të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**), Këshilli Drejtues i AKEP:

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me VKD Nr.85, datë 30.10.2018 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k dhe Albtelecom sh.a”;
2. Ngarkohet Komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për njoftimin e palëve të interesuara “Nisatel sh.p.k” dhe “Albtelecom sh.a”.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit 45 ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Illir ZELA

Edlira DVORANI

Klarina ALLUSHI

Ketrin TOPÇIU